

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është krijuar në vitin 2006, me vendim gjykatë Nr. 36760, datë 04.12.2006. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Shoqëritë tregtare” dhe nga statuti i saj.

Shoqëria Hyundai Auto Albania Shpk është shoqëri shqiptare. Ortak i vetëm është z. Ilir Zeka që zotëron 100% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë.

Kapitali i Shoqërisë është 100.000 lekë. Administrator i Shoqërisë nga data 19.07.2011 deri më 18.07.2024 është emëruar z. Ilir Zeka.

Selia e Shoqërisë ndodhet tek Autostrada Tiranë-Durrës, Kilometri 1, Godinë 4 kate, Kashar, Tiranë. Shoqëria është regjistruar me NIPT K62420006T.

Aktiviteti kryesor i kësaj Shoqërie është import automjeteve, shërbim riparimi të tyre.

Në 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka 21 punonjës (2018: 21).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për Shpalljen e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara, duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i Shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme, të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, janë përshkruar më poshtë:

(Vlerat janë në Lek)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Vlerësimet kritike të kontabilitetit**

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

2.5.2. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara, të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në ç'regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.3. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste Shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahuesueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr. 1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale, me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit të monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
EUR/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare, instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar, duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes, duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeletar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.3. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.4. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve, në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.5. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto, duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e ç'montimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.5. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material, duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në %		Metoda e llogaritjes
	2019	2018	
Toka	0	0	
Ndërtime e instalime	5	5	
Makineri e Pajisje	20	20	
Mjete transporti	20	20	Mbi vlerën e mbetur të AAM-ve
Pajisje zyre	20	20	
Pajisje kompjuterike	25	25	
Instrumenta dhe vegla pune	20	20	

iv. Ç'regjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç'regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritjeje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjata të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit, përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.8. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15% (2018: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimin e pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme, që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës, sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë konsiderohen si palë të lidhura.

3.13. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.14. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare, por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozita në bankë e llogari të tjera	2,090,961	40,147,540
Vlera në arkë	861,060	651,064
Depozita garancie në bankë	8,000,000	-
	10,952,021	40,798,604

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë për mallra, produkte dhe shërbime	594,836,821	585,212,127
	594,836,821	585,212,127

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime palë të lidhura	50,204,091	33,001,960
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim Fitimi	10,368,590	-
Shteti Tatime dhe Taksa - Tatim në Burim	99,051	95,372
Paradhënie për punonjësit	811,959	661,908
Të tjera kërkesa	188,437	512,168
Llogari ne pritje	1,012,356	208,709
Taksa doganore	-	122,364
TVSH e arkëtueshme	-	12,544,628
	62,684,484	47,147,109

7. Parapagime për furnizime

Parapagime për furnizime detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime për mallra, produkte, shërbime	87,103,231	85,681,687
	87,103,231	85,681,687

8. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si me poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Inventar i imët	367,227	-
Mallra Grupi I	200,457,310	169,258,382
	200,824,537	169,258,382

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme	-	3,472,000
Parapagime RBS	42,600	-
	42,600	3,472,000

10. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2018	5,130,820	5,161,594	88,130,797	14,012,918	112,436,129
Shtesa	-	1,483,861	19,040,954	128,609	20,653,424
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(7,674,312)	-	(7,674,312)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	5,130,820	6,645,455	99,497,439	14,141,527	125,415,241
Shtesa	-	226,305	40,395,066	288,341	40,909,712
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	(29,064,037)	-	(29,064,037)
Gjendja me 31 dhjetor 2019	5,130,820	6,871,760	110,828,468	14,429,868	137,260,916
Amortizim i akumuluar					-
Gjendja më 1 janar 2018	1,160,689	3,691,375	18,034,061	6,958,490	29,844,615
Amortizimi i vitit	198,507	715,829	15,489,945	1,145,356	17,549,637
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(2,656,855)	-	(2,656,855)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,359,196	4,407,204	30,867,151	8,103,846	44,737,397
Amortizimi i vitit	188,581	562,330	15,679,326	1,261,951	17,692,188
Nxjerrje jashte perdorimit	-	-	(8,766,848)	-	(8,766,848)
Gjendja me 31 dhjetor 2019	1,547,777	4,969,534	37,779,629	9,365,797	53,662,737
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 dhjetor 2018	3,771,624	2,238,251	68,630,288	6,037,681	80,677,844
Gjendja më 31 dhjetor 2019	3,583,043	1,902,226	73,048,839	5,064,071	83,598,179

Hyundai Auto Albania sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë në Lek)

11. Huatë

Huatë më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

Huadhenesi	Lloji Huase	Data e marrjes se Huase	Data e Shlyerjes se Huase	Afati	Monedha	Principali	Balanca e Mbetur 31.12.2019		Shuma për t'u shlyer deri	
							EUR	ALL	ne 1 vit	mbi 1 vit
Nga Bankat										
Intesa San Paolo	OVD	01.08.2018	03.07.2019	1 Vit	EUR	300,000	299,790	36,505,447	36,505,447	-
							299,790	36,505,447	36,505,447	-
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	06.09.2017	05.04.2021	42 muaj	EUR	537,315	2,858	347,999	347,999	0
Raiffeisen Leasing	Leasing	14.11.2017	13.11.2020	36 muaj	EUR	17,837	8,520	1,037,505	1,037,505	(0)
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	03.07.2019	02.01.2023	42 muaj	EUR	99,418	12,671	1,542,948	514,316	1,028,632
Raiffeisen Leasing	Financim stoku	02.10.2019	01.03.2023	42 muaj	EUR	200,080	200,080	24,363,742	6,961,069	17,402,673
Raiffeisen Leasing	Leasing	14.10.2019	13.10.2022	36 muaj	EUR	17,930	16,731	2,037,300	582,086	1,455,214
Raiffeisen Bank	OVD				EUR	200,000	184,777	22,500,307	22,500,307	-
							425,637	51,829,800	31,943,282	19,886,518
Procredit Bank	OVD	28.05.2018	27.05.2019	1 Vit	EUR	100,000	100,000	12,177,000	12,177,000	-
Procredit Bank	Kredi			1 Vit	EUR	50,000	25,256	3,075,362	3,075,362	-
							125,256	15,252,362	15,252,362	-
OTP	Kredi	21.10.2015	20.10.2020	5 vjet	EUR	49,500	7,561	920,653	920,653	-
OTP	OVD	05.05.2018	04.05.2019	1 Vit	EUR	100,000	101,279	12,332,750	12,332,750	-
OTP	OVD	24.12.2018	23.03.2019	3 muaj	EUR	300,000	303,929	37,009,403	37,009,403	-
OTP	OVD	23.12.2019	22.12.2019	1 Vit	EUR	225,000	225,219	27,424,968	27,424,968	-
							637,988	77,687,773	77,687,773	-

Huatë(vazhdim)						Balanca e				
Huadhenesi	Lloji Huase	Data e marrjes se Huase	Data e Shlyerjes se Huase	Afati	Monedha	Principali	Mbetur 31.12.2019		Shuma për t'u shlyer deri	
							EUR	ALL	ne 1 vit	mbi 1 vit
Banka Credins	Leasing	22.06.2017	21.06.2020	3 Vjet	EUR	10,000	1,444	175,802	175,802	-
Banka Credins	Leasing	28.09.2017	27.09.2020	3 Vjet	EUR	21,833	2,309	281,186	281,186	-
Banka Credins	Leasing	02.11.2017	01.11.2020	3 Vjet	EUR	23,333	6,094	742,013	742,013	-
Banka Credins	Leasing	14.11.2017	13.11.2020	3 Vjet	EUR	10,000	2,612	318,005	318,005	-
Banka Credins	Financim stoku	27.03.2018	26.03.2021	3 Vjet	EUR	23,333	8,221	1,001,082	800,865	200,217
Banka Credins	Leasing	17.08.2018	16.08.2021	3 Vjet	EUR	29,167	13,435	1,636,038	981,622	654,416
Banka Credins	Financim stoku	07.09.2018	06.09.2021	3 Vjet	EUR	197,428	6,516	793,500	453,429	340,071
Banka Credins	Financim stoku	30.10.2018	29.10.2021	3 Vjet	EUR	109,953	5,220	635,659	346,723	288,936
Banka Credins	Leasing	19.12.2018	18.12.2021	3 Vjet	EUR	33,333	18,261	2,223,629	1,111,815	1,111,814
Banka Credins	Financim stoku	16.01.2019	15.01.2022	3 Vjet	EUR	109,206	18,597	2,264,520	754,840	1,509,680
Banka Credins	Leasing	19.01.2019	18.01.2022	3 Vjet	EUR	18,667	13,285	1,617,752	539,251	1,078,501
Banka Credins	Financim stoku	15.02.2019	14.02.2022	3 Vjet	EUR	117,290	24,293	2,958,148	986,049	1,972,098
Banka Credins	Financim stoku	21.03.2019	20.03.2022	3 Vjet	EUR	95,366	13,641	1,661,052	553,684	1,107,368
Banka Credins	Leasing	21.06.2019	20.06.2022	3 Vjet	EUR	71,000	64,596	7,865,832	2,621,944	5,243,888
Banka Credins	Leasing	02.07.2019	01.07.2022	3 Vjet	EUR	18,667	16,222	1,975,352	658,451	1,316,901
Banka Credins	Leasing	02.07.2019	01.07.2022	3 Vjet	EUR	14,933	11,932	1,452,943	484,314	968,628
Banka Credins	Financim stoku	17.07.2019	16.07.2022	3 Vjet	EUR	99,418	98,831	12,034,640	4,011,547	8,023,093
Banka Credins	Leasing	26.09.2019	25.09.2022	3 Vjet	EUR	19,000	17,513	2,132,512	710,837	1,421,674
Banka Credins	Financim stoku	01.10.2019	30.09.2022	3 Vjet	EUR	86,083	30,250	3,683,563	1,227,854	2,455,709
Banka Credins	Financim stoku	14.10.2019	13.10.2022	3 Vjet	EUR	301,588	201,503	24,537,045	8,179,015	16,358,030
Banka Credins	Leasing	07.11.2019	06.11.2022	3 Vjet	EUR	16,925	16,925	2,060,933	686,978	1,373,955
Banka Credins	Financim stoku	03.12.2019	02.12.2022	3 Vjet	EUR	153,371	135,439	16,492,368	5,497,456	10,994,912
Banka Credins	Leasing	04.12.2019	03.12.2022	3 Vjet	EUR	17,333	17,333	2,110,681	703,560	1,407,121
							744,471	90,654,253	32,827,240	57,827,013

11. Huatë(vazhdim)

Huadhenesi	Lloji Huase	Data e marrjes se Huase	Data e Shlyerjes se Huase	Afati	Monedha	Principali	Balanca e Mbetur 31.12.2019		Shuma për t'u shlyer deri	
							EUR	ALL	ne 1 vit	mbi 1 vit
Albanian Financial Institution	Financim stoku	03.04.2017	02.04.2020	3 vjet	EUR	321,203	35,294	4,297,728	4,297,728	-
Albanian Financial Institution	Financim stoku	01.11.2017	31.10.2020	3 vjet	EUR	356,218	-	-	-	-
							35,294	4,297,728	4,297,728	-
Hua nga BKT me Classic shpk	OVD	16.12.2016	16.12.2019	3 Vjet	EUR	150,000	145,000	17,656,650	-	17,656,650
Hua nga BKT me Classic shpk	OVD	19.09.2018	18.09.2019	1 Vit	EUR	150,000	150,000	18,265,500	18,265,500	-
							295,000	35,922,150	18,265,500	17,656,650
Classic S & J	Kredi	11.03.2018	11.03.2019	1 Vit	EUR	686,000	348,168	42,396,417	-	42,396,417
							348,168	42,396,417	-	42,396,417
Tirana Factoring & Lease	Financim Stoku	27.07.2016	27.07.2017	1 Vit	EUR	430,000	134,783	16,412,495	16,412,495	0
Tirana Factoring & Lease	Financim Stoku	13.03.2018	12.03.2023	5 Vjet	EUR	35,417	19,519	2,376,860	707,327	1,669,534
Tirana Factoring & Lease	Financim Stoku	19.06.2018	18.06.2020	2 Vjet	EUR	112,698	737	89,685	89,685	(0)
							155,039	18,879,041	17,209,507	1,669,534
UBA	Kredi	30.08.2018	29.08.2023	5 Vite	EUR	450,000	347,796	42,351,142	10,017,981	32,333,161
							347,796	42,351,142	10,017,981	32,333,161
Abi Kredi	Kredi	08.11.2019	07.11.2022	3 Vjet	EUR	185,000	182,228	22,189,916	22,189,916	-
Abi Bank	OVD	08.11.2019	07.11.2020	1 Vit	EUR	500,000	499,970	60,881,304	60,881,304	-
							682,198	83,071,220	83,071,220	-
Erion Zhorbo Gurten shpk	Hua	23.12.2019	23.06.2020	6 muaj	EUR	10,000	10,000	1,217,700	1,217,700	-
								30,442,500		30,442,500
Landeslease	Leasing	21.08.2019	20.08.2022	3 Vjet	EUR	20,667	19,142	2,330,890	776,963	1,553,926
First Investment Bank	OVD				ALL	41,000,000	-	41,298,732	41,298,732	-
							4,125,777	574,137,155	370,371,435	203,765,720

(Vlerat janë në Lek)

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	109,746,060	104,202,016
	<u>109,746,060</u>	<u>104,202,016</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Sigurimet shoqërore	480,006	572,156
TVSH për tu paguar	8,828,476	-
Tatimi mbi fitimin	-	2,280,442
Tatimi mbi të ardhurta personale të punonjësve	177,944	260,134
	<u>9,486,426</u>	<u>3,112,732</u>

14. Të ardhurat e shtyra

Të ardhurat e shtyra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018, paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Parapagime të marra për blerje makinash	14,292,369	22,952,244
	<u>14,292,369</u>	<u>22,952,244</u>

15. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Zyra e Shërbimit Përmbartimor (Autoriteti Konkurrencës)	5,070,660	5,070,660
Të tjera detyrime ndaj ortakut	65,443,725	67,167,549
Të tjera detyrime	-	4,955,509
	<u>70,514,385</u>	<u>77,193,718</u>

16. Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 100,000 LEK, i zotëruar 100% nga ortakut i vetëm Ilir Zeka. Kapitali më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>			<u>31 dhjetor 2018</u>		
	<u>Kuotat</u>	<u>Vlera nominale</u>	<u>%</u>	<u>Kuotat</u>	<u>Vlera nominale</u>	<u>%</u>
Ilir Zeka	100	1000	100%	100	1000	100%
	<u>100</u>	<u>1000</u>	<u>100%</u>	<u>100</u>	<u>1000</u>	<u>100%</u>

Shoqëria ka fitim më 31 dhjetor 2019 në vlerën 17,260,945 LEK (2018: 66,609,099 LEK).

17. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Nga shitje automjetesh	1,039,404,155	2,169,268,416
Kryerja e shërbimeve (Servis automjetesh)	8,835,517	8,471,363
Nga shitja e pjesëve të këmbimit për automjete	83,640,638	77,267,052
Dhënie automjetesh me qera	23,949,747	34,721,167
	1,155,830,057	2,289,727,998

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Qarkullim i tatueshëm	1,179,981,370
Zbriten parapagimet në çelje	22,952,244
Shtohet parapagimet në mbyllje	(14,292,369)
Zbritet VKN e aktiveve të shitura paraqitur neto	(20,297,189)
Te ardhura nga rivleresimet	1,728,398
Shuma e qarkullimit të korrektuar	1,170,072,454
Sipas Kontabilitetit	1,170,072,454
Diferenca	-

18. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe rezultatin nga shitja e AAM-ve, të cilat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	20,276,591	4,092,868
Vlera e mbetur e AAM-ve të shitura	(20,297,189)	(5,017,457)
Të ardhura të tjera	12,534,597	9,597,626
Fitim nga këmbimet valutore	1,728,283	15,481,873
	14,242,282	24,154,910

19. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen me veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Blerje shpenzim mallra/pjesë këmbimi	977,460,622	2,003,607,127
Qira ndërtese e automjeteve	10,826,750	10,997,540
Takse doganore e skanimit	2,380,573	3,678,403
Transport në blerje për pjesë dhe makina	17,060,398	38,176,415
Shpenzime për karburant	453,616	477,404
Shpenzime për agjensi doganore	1,094,715	1,886,108
Shpenzime riparimi e rregjistrimi automjeteve	9,812,402	10,436,945
Shpenzime për marrje makina me qera	308,500	62,000
Rregjistrim automjeteve	10,420,306	14,795,760
Update i kontrollit dhe servisit makina	772,010	1,539,260
Sigurim mjeteve dhe TPL	3,844,875	12,411,293
Akciza	1,497	1,757
Taksa vendore	673,000	677,000
	1,035,109,264	2,098,747,012

20. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Telefoni, internet e DHL	461,315	530,845
Komisione bankare	2,228,401	2,770,385
Shpenzime udhëtim e dieta	1,930,178	1,714,587
Shpenzime për roje private	3,291,999	3,291,667
Personel nga jashtë, konsulence e honorare	550,000	550,000
Shpenzime për energji	791,898	909,782
Shpenzime përfaqësimi e pritje përcjellje, reklama	522,779	5,106,276
Shpenz. noterizimi, përmbarimi, gjyqësore e siguracione	1,120,388	1,817,374
Shpenzime për kanceleri e dokumenta	353,316	236,494
Shpenzime për mirëmbajtje ambjenti, trajtim punonjësve	189,700	602,200
Shpenzime të ndryshme	1,253,669	5,976,694
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	10,541,250	20,943,671
Shpenzime për mbyllje parakohe të kontratës së shitjes së makinave	2,028,290	2,898,698
Sigurim garancie malli	610,590	548,945
Shpenzime pa fatura	6,458,114	2,269,684
	32,331,887	50,167,302

21. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për paga	21,570,616	22,533,097
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	3,317,232	3,330,002
	24,887,848	25,863,099

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2019 është 21 (2018: 21).

22. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime të tjera detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Gjoha dhe dëmshpërblime	78,421	1,831,666
	78,421	1,831,666

23. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për interesa	(35,848,655)	(35,566,165)
Të ardhura nga interesat	69,636	3,674
	(35,779,019)	(35,562,491)

24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitimi para tatimit	24,193,712	84,161,701
Total shpenzime të panjohura	22,024,735	32,855,646
Gjoha dhe penalitete	93,915	1,831,666
Shpenzime me fatura jo të rregullta tatimore	6,514,928	3,707,736
Shpenzim për regjistrim mjeti pa faturë	2,199,929	2,723,131
Shpenzime për mbyllje parakohore të kontr. Shitjes makinës	2,028,290	2,898,698
Shpenzime të tjera pa dokumenta të rregullta	10,803,143	20,943,671
Shpenzime për interesa të panjohura	384,529	750,744
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	46,218,447	117,017,347
Tatim fitimi @15%	6,932,767	17,552,602
	17,260,945	66,609,099

25. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit e deklaroi koronavirusin (COVID-19) një pandemi. Ndërsa situata është ende duke u zhvilluar në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Impakti financiar do të njihet nga Kompania gjatë vitit 2020. Menaxhimi do të vazhdojë të monitorojë ndikimin e mundshëm dhe do të ndërmarrë të gjitha hapat e mundshëm për të lehtësuar çdo efekt. Menaxhimi e konsideron këtë pandemi si një ngjarje që nuk rregullohet pas datës së raportimit dhe e ka shpalosur në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Efektet mbi bazën e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 2.5.1 "vlerësimet kritike të kontabilitetit" të këtyre pasqyrave financiare.

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.